4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Listat e Çmimeve sipas zërave të preventivit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 6: Grafiku i realizimit të punimeve

Shtojca 7: Formularët e Përshtatshmërisë dhe Kualifikimit të Ofertuesve

Shtojca 8: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 9: Formulari i Vlerësimit

Shtojca 10: Preventivat e Punimeve

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit .

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁴

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'ë realizojmë për Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), punimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në preventiv, me të gjitha projektet teknike, e me kërkesat në detyrën e projektimit apo termat e referencës, nëse është rasti, dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Vlerësimit;
 - 4. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 5. Specifikimet teknike, Projektet dhe çdo dokumentacion teknik;
 - 6. Preventivin e çmimeve
 - 7. Termat e referencës (nëse është rasti)
 - 8. Detyrën e projektimit (nëse është rasti)
 - 9. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

⁴ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

10. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

(e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

(f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë]**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë	

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** _____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë zëra në Formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventivit dhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zërat e preventivit pa vlerë do të konsiderohen si zëra të paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Oferta ekonomike e detajuar

Nr	Nr. Analizë	Përshkrimi i Punëve	Njësi	Sasia	Çmimi/ Njësi	Cmimi total
1.						
2.						
3.						
Shuma						
Fondi Rezervë						
Shuma						
TVSH						
SHUMA TOTAL						

Nënshkrimi i ofertuesit _____**Vula****Shënim:** Çmimet duhet të shprehen në Monedhën ____ (e kërkuar në dokumentat e tenderit)

Shtojca 3.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit /entit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Të dhënat teknike të punëve objekt prokurimi duhet të përshkruhen sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

SHËNIM: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për eficientësinë e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 6.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

GRAFIKUT I ZBATIMIT TË PUNIMEVE

Afatet e realizimit të punimeve: 18 (Tetëmbëdhjetë) muaj nga dorëzimi i sheshit të ndërtimit nga mbikqyrësi i punimeve.

Shënim. Autoriteti/enti kontraktor mund të shtojë rreshta në varësi të zërave të punimeve dhe kollona në varësi të afatit të parashikuar për realizimin e tyre.

Shtojca 7.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkuar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme përvërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;*
- b) *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale: Sipas shtojcës 7 të këtyre dokumenteve.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga ana e tyre gjatë tre viteve të fundit financiare (2023-2024-2025). Vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 100% e fondit limit të procedurës së prokurimit.

Kërkesa për plotësimin e këtij kriteri konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një vërtetim nga Dega e Tatim Taksave për xhiron vjetore të realizuar në 3 (tre) vitet e fundit.

2.2.2 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit financiare 2023, 2024 dhe 2025. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të bilanceve të këtyre tre viteve, të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse dhe të konfirmuara nga ky autoritet, Dega e Tatim Taksave.

Në këtë rast kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore në vendet ku kanë ushtruar apo ushtrojnë aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin 2025 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2026, sipas ligjit nr. 9632 date 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të BOE duhet të dorëzojë vërtetimet e lëshuara nga njësite ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2025 dhe 2026.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

2.3 Kapaciteti teknik:

Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3 Kapaciteti teknik:

Për sa i përket aftësisë teknike e profesionale, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si vijon:

2.3.1 Operatorët ekonomikë duhet të kenë përvojë të suksesshme në kontrata të mëparshme dhe për këtë duhet të paraqesin :

Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të ulët se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht $549,972,223.69 \times 50\% = 274,986,111.85$ lekë (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e ulët se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht $549,972,223.69 \times 2 = 1,099,944,447.38$ lekë (pa TVSH).

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentet e mëposhtme:

a) Për kontrata të realizuara me ente publike operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, (ku të përcaktohet qartë vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer) shoqëruar me:

Kontratë Sipërmarrje;

Situacionin përfundimtar;

Fatura tatimore të situacionit përfundimtar të deklaruara në organet tatimore;

Aktin e kolaudimit;

Certifikaten e marrjes në dorezim të perkohshëm/përfundimtar.

Shënim : Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm :

Vertetim leshuar nga subjekti privat, shoqëruar me:

Kontrate Sipërmarrje;

Situacionin përfundimtar;

Fatura tatimore të situacionit përfundimtar të deklaruara në organet tatimore;

Akt kolaudimi objekti.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontraten e bashkimit të operatoreve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi (2.3.1 – a/b)

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe në nenin 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë :

$549,972,223.69 \times 50\% = 274,986,111.85$ lekë. (Dyqind e shtatëdhjetë e katër milionë e nëntëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e njëmbëdhjetë lekë e tetëdhjetë e pesë qindarka) pa TVSH.

$549,972,223.69 \times 2 = 1,099,944,447.38$ lekë (Një miliard e nëntëdhjetë e nëntë milionë e nëntëqind e dyzet e katër mijë e katërqind e dyzet e shtatë lekë e tridhjetë e tetë qindarka) pa TVSH.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, është kërkuar edhe paraqitja e kontratës së bashkimit të operatoreve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE, mbështetur në parashikimet e nenit 88 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij dokumentacioni AK ka mundësi të njihet me vlerën reale të punimeve të realizuara nga ofertuesi/t, mbi bazën e një kontrate të realizuar si BOE.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor është kërkuar edhe miratimi nga ana e autoritetit kontraktor, si nënkontraktor i deklaruar, në respektim të parashikimeve të nenit 89 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Pra, dokumentacioni i kërkuar si më sipër, është kërkuar me qëllim që AK të përlogarisë vlerën e saktë të kontratave të mëparshme të realizuara nga ofertuesi, brenda afatit të përcaktuar në pikën 2.3.1, shkronja a) dhe b).

2.3.2 Licenca profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, të ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :

N.P. - 1 A Punime gjurmimi në tokë;

N.P. - 2 B Ndërtime civile dhe industriale;

N.P. - 3 A Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash

N.P. - 5 B Punime nëntokësore, ura e vepra arti;

N.P. - 11 E Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.

Për punimet speciale të ndërtimit :

N.S. - 1 A Punime për prishjen e ndërtimeve;

N.S. - 2 A Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre;

N.S. - 4 A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me Material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtues;

N.S. - 8 B Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri;

N.S. - 12 A Impiante teknologjik, termik dhe te kondicionimit.

N.S. - 13 A Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni TV.

N.S. - 14 A Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV.

Licensa profesionale në fushën e projektit:

3. PROJEKTUES KONSTRUKTOR.

d- Vlerësimi i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse prej beton-arme, murature dhe metalike.

4. PROJEKTUES INSTALATOR

c- Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industrial

10. PROJEKTIMI I IMPIANTEVE TË PRODHIMIT DHE SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE

d- Nënstacione elektrike, primare sekondare - linja të tensionit të lartë.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008).

Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi 2.3.2

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” (lidhja 2, 3 dhe 4).

Për sa u përket kategorive të licensave profesionale në fushën e zbatimit ato janë përcaktuar nga preventivi i detajuar, volumet përkatëse të tyre sipas projekt idese së paraqitur, referuar çmimeve në e-Albania, cmimeve të pajisjeve, punimeve civile, montimi etj për punimet e menduara që janë përdorur për llogaritjen e fondit limit të këtij projekti.

Përsa i përket preventivit që është bashkengjitur DT ai është menduar i përmbledhur, duke qenë sipas kriterit “çelese në dorë” dhe duke u lene mundësi OE që na varesi të pajisjeve zgjidhjeve teknike që ata do të ofrojnë të kenë hapësirën e mjaftueshme si për zgjidhjen teknike të tyre, ashtu edhe atë ekonomike për pajisjet, bazamentet konstruksionet metalike, punime civile punime gjurmimi për këtë projekt.

Konkretisht:

Kategoritë e licensave janë përcaktuar bazuar në zërat e punimeve që parashikohet të realizohen në funksion të përmbushjes së qëllimit të kontratës, ndërsa klasifikimi i tyre, sipas niveleve (gërmime) përkatëse është përcaktuar në klasifikimin bazë (A) pasi volumet e punës që do të realizohen janë vetëm sasi / punime të planifikuara.

Keto licensa dhe kategori janë të domosdoshme për realizimin e punimeve rikonstruksionin, fuqizimin dhe kalimi në nivel tensioni 110kV të Nënstacionit Kinostudio, për arsye të mëposhtme:

Është N.Stacion elektrik në punë, me tension, dhe kryerja e punimeve do të realizohet duke mos ndërprerë punën e tij të furnizimit me energji elektrike të konsumatoreve, duhet të kryhen në kushte maksimale sigurie dhe të kenë kualifikimet e nevojshme për këto procese pune specifike.

Licensat dhe kategoritë përkatëse vërtetojnë kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit ekonomik lidhur me staf të kualifikuar profesionalisht, si dhe mjete pune të nevojshme për realizimin në kohë të projektit brenda afatit të parashikuar.

Licencat profesionale përbëjnë gjithashtu garanci ligjore dhe teknike se operatori ekonomik disponon kapacitetet profesionale, organizative dhe teknike për të realizuar objektin e kontratës në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare për këto punime, si dhe me kërkesat e Autoritetit Kontraktor.

Sigurojnë realizimin e plotë projektit në të gjitha fushat e projektit, që kërkon rikonstruksionin dhe fuqizimin i këtij nënstationi sipas përshkrimeve të mëposhtme:

Projekt elektrik i detajuar.

Punime civile dhe arkitektonike;

Punime konstruktive;

Instalime elektrike të tensionit të lartë dhe të mesëm;

Sisteme komandimi, mbrojtjeje dhe automatizimi (SCADA),

telekomunikacioni, DGA, BMT etj.

Sisteme tokëzimi dhe mbrojtjeje nga mbitensionet dhe shkarkimet atmosferike;

Instalime elektrike, mekanike, ndihmëse etj.

Gjithashtu në proces verbalin e mbajtur për miratimin, argumentimin e specifikimeve teknike dhe kërkesave për kualifikim AK ka argumentuar me detaje secilën prej kategorive të lëncave të kërkuara.

N.P - 1 A “Punime gjërmimi në tokë”

Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria N.P - 1 A “Punime gjërmimi në tokë” konsiderohen gjërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloji mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në zërat e preventivit për realizimin e punimeve për germime per ndertesen e re te N.Stacionit, kanale kablllo, muret rrethues, etj. konkretisht për punimet si vijon:

Zerat dhe volumet sipas preventivit.

Punime germimi		
Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , per bazament transformator fuqie	m ³	46.00
Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , per bazament transformator fuqie	m ³	4.52
Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , per bazament transformator fuqie	m ³	2.63
Germim dheu me krah per kanal kablli	m ³	29.60
Germim dheu me krah per kanal poshte celave	m ³	102.60
Germim dheu me krah per kanal kablli	m ³	388.50

N.P. - 2 B Ndërtime civile dhe industriale;

Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria N.P - 2 B Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta, në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në zërat e preventivit për realizimin e punimeve për objektin ndertese e re, bazamente te pajisjeve te N.Stacionit, muret rrethues, etj. konkretisht për punimet si vijon:

Zerat dhe volumet sipas preventivit.

Ndertime civile dhe industriale		
Shtrese betoni C 12/15 (t=10cm)	m ³	5.30
Struktura monolite betoni me çakell C 25/30	m ³	32.00
Shtrese betoni C 12/15 (t=10cm)	m ³	0.32
Struktura monolite betoni me çakell C 25/30 per bazamentin	m ³	1.95
Shtrese betoni C 12/15 (t=10cm)	m ³	0.23

Struktura monolite betoni me çakell C 25/30 per bazamentin	m ³	1.32
Shtrese betoni C12/15 t=10 cm	m ³	0.11
Struktura monolite betoni me çakell C 25/30	m ³	0.33

N.P. - 3 A “Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash”.

Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria N.P - 3 A “Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash” konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim, konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim. Konsiderohen gjithashtu dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në zërat e preventivit për realizimin e punimeve në fasada ekzistuese dhe të reja, për objektin ndertese ekzistuese dhe të re të N.Stacionit, konkretisht për punimet si vijon:

Zerat dhe volumet sipas preventivit.

Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale		
Prishje suvatim i jashtem	m ²	86.40
Suva brenda mur tulle h~4m me krah, llaç perzier M 25	m ²	874.00
Patinim tavani me stuko	m ²	533.30
Suva e zakonshme fasade mur tulle+ xokol h ~ 8 m	m ²	535.00

N.P. - 5 B “ Punime nëntokësore, ura e vepra arti ”

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime, me anë të përdorimit të mjeteve teknike speciale, të ndërhyrjeve nëntokë që janë të lidhura me ndjeshmërinë e lëvizshmërisë mbi "goma" ose mbi "hekur", kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësime ose pajisje, në pika të veçanta ose në rrjet, rrugët hyrëse të çdo shkalle rëndësie, devijimet në nivele dhe në lartësi, punime të mureve mbajtëse.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar galeritë natyrore, shpime, kalime nëntokësore, tunele.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në zërat e preventivit për realizimin e punimeve për kanale kabllorë nëntokë, germime për baamentet e transformatoreve të fuqisë, etj. konkretisht për punimet si vijon:

Zerat dhe volumet sipas preventivit.

Punime nentokesore		
Struktura monolite betoni me çakell C 25/30	m ³	32.00
F.V. hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm	ton	0.970
F.V. hekur betoni periodik Ø > 10 mm	ton	1.000
F.V. tuba çeliku i zi	kg	30.00
F.V. detaje metalike ne b/a (profilat metalike + pllakat metalike)	ton	0.342
Konstruksione metalike te thjeshta	ton	0.592
Struktura monolite betoni me çakell C 25/30 per bazamentin	m ³	1.95
F.V. hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm	ton	0.080
F.V. hekur betoni periodik Ø > 10 mm	ton	0.024
Shtrese betoni C 12/15 (t=10cm)	m ³	0.23
Struktura monolite betoni me çakell C 25/30 per bazamentin	m ³	1.32
F.V. hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm	ton	0.062
F.V. hekur betoni periodik Ø > 10 mm	ton	0.024

N.P. - 11 E “Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e

T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike”.

Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria N.P - 11 E “Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike” konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshëm për shpërndarjen e T/N dhe tensionit të mesëm dhe për transformimin dhe shpërndarjen e tensionit të ulët deri te përdoruesit e energjisë elektrike, të kompletuar me punimet e muraturës, plotësuese ose ndihmëse, të veçanta ose të rrjetit.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar centrale dhe kabina transformacioni, shtyllat metalike të nevojshme për transportin dhe shpërndarjen e çfarëdo lloji tensioni, furnizimin dhe vendosjen në vepër të linjave elektrike për çfarëdo numër fazash elektrike, ajrore ose tokësore.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në zërat e preventivit për realizimin e punimeve të ndryshme elektrike si ne pajisjet e tensionit te larte, te mesem TU, ne N.Stacion dhe në ndërtesat e tij si vijon:

Zerat dhe volumet sipas preventivit.

Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike		
Transformatore fuqie 115/20.8/6.3kV, 40/50 MVA ONAN/ONAF i kompletuar	cope	1
Sistem DGA per transformator fuqie 115/20.8/6.3kV,	komplet	1
Sistem BMT per transformatore fuqie 115/20.8/6.3kV,	komplet	1
Çeles tre polar 110kV, 1250A, 31.5kA i kompletuar	cope	3
Ndares tre polar 110kV, 1250A, 31.5kA, shoqeruar me nje ndares toke i kompletuar	cope	3
Ndares tre polar 110kV, 1250A, 31.5kA, shoqeruar me dy ndares toke i kompletuar	cope	3
Transformator rryme nje polar 110kV	cope	9
Transformator kapacitiv tensioni nje polar 110kV me tre peshtjella sekondare	cope	12
Shkarkues 110kV, nje polar me numrator shkarkimesh per faze	cope	9
Terminal kabllor 110kV	cope	6
Panel Marshalling kiosk per traktet e linjes 110 kV	cope	2
Panel i mbrojtjes i pajisur me mbrojtje distancionale. Mbrojtje Max/Çasti dhe mbrojtje rezerve back up	cope	2
Panele te kompletuar me BCU, me pajisje per monitorimin e alarmeve dhe skeme mimike, multi meter per kontrollin e traktit 110kV te linjes	cope	2
Çele e kompletuar matje/mbrojtje 35kV, 1250A, 31.5kA 110 V DC, kryesore transformatorit, me çeles me vakum ose gaz, izolacioni i zbarrave me gaz me transformatore tensioni 35/0.1kV	cope	2
Çele e kompletuar matje/mbrojtje 35kV, 1250A, 31.5kA 110 V DC, linje, me çeles me vakum ose gaz, izolacioni i zbarrave me gaz	cope	2
Ndares tre polar, pozicion vertikal ne portal, 40.5 kV, 630A, me tokezim, kabina 35kV	cope	3

Çele e kompletuar matje/mbrojtje 24kV, 1600A, 31.5kA 110 V DC, kryesore transformatorit, me çeles me vakum ose gaz.	cope	2
Çele e kompletuar matje/mbrojtje 6(24)kV, 630A, 25kA 110 V DC, kryesore transformatorit, me çeles me vakum ose gaz dhe transformatore tensioni 6/0.1kV ana 6kV	cope	1
Çele e kompletuar matje/mbrojtje 24/6kV, 630A, 25kA 110 V DC, fideri, me çeles me vakum ose gaz.	cope	15
Çele e kompletuar matje/mbrojtje 24kV, 630A, 25kA 110 V DC, nevojat vetjake, me çeles me vakum ose gaz.	cope	1
Çele e kompletuar matje/mbrojtje 24kV, 1600A, 31.5kA 110 V DC, seksionimi i zbarrave, me çeles me vakum ose gaz + zbarralidhes	cope	1
Çele e kompletuar matje/mbrojtje 24kV, 25kA 110 V DC, matje me transformatore tensioni 20/0.1kV.	cope	2
Transformatore te nevojave vetjake 250 kVA 20/0.4 kV	cope	1
Panel i shperndarjes AC 400/230V, 50Hz.	cope	2
Panel i shperndarjes DC 110V DC	cope	2
Radrizator 400V AC / 110V DC me panel kontrolli	cope	2
Radrizator 400 V AC / 48V DC me panel kontrolli	cope	1
Salle baterish 110V DC, te thata me gel (12V, 100Ah) me gjithë aksesoret (10 cope/seti)	set	2
Salle baterish 48V DC, te thata me gel (12V, 100Ah) me gjithë aksesoret (5 cope/seti)	set	1

N.S – 1 A “Punime për prishjen e ndërtimeve”.

Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria N.S - 1 A “Punime për prishjen e ndërtimeve”, konsiderohet çmontimi i impianteve industriale dhe prishja komplet e ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksplozivi me prerje të strukturave betonarmeje dhe prishjeve në përgjithësi përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në zërat e preventivit për realizimin e punimeve të ndryshme ndërtimore që paraprihen nga punimet e prishjes, konkretisht për punimet si vijon:

Zerat dhe volumet sipas preventivit.

Punime Prishjeje		
Prishje mur tulle pa pastrim	m ³	144.12
Prishje arkitra b/a	m ³	0.85
Prishje suvatim muri i brendshem	m ²	651.00
Heqje pllaka dysHEMEJE	m ²	379.00
Prishje shtresa betoni	m ³	57.00
Prishje solete + strehe b/a	m ³	35.20
Prishje breza b/a	m ³	3.60
Heqje zgara hekuri ekzistuese	m ²	54.03
Heqje dritare ekzistuese	m ²	53.03
Heqje dyer ekzistuese	m ²	37.60
Prishja e davancaleve ekzistuese (dritareve)	m ²	14.32
Prishje suvatim i jashtem	m ²	86.40

N.S - 2 A “Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre”.

Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria N.S - 2 A “Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre” konsiderohet, montimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i impianteve hidrosanitare të kuzhinës, lavanterisë së gazit dhe kundër zjarrit, sado që të jetë shkalla e rëndësisë së veprave, e kompletuar me punimet e muraturës plotësuese ose ndihmëse, që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithëshme.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në zërat e preventivit për realizimin e punimeve të ndryshme ndërtimore, konkretisht për punimet si vijon:

Zerat dhe volumet sipas preventivit.

Punime hidraulike dhe hidrosanitare		
F.V. lavaman porcelani importi +grup	cope	1
F.V. pisuar porcelani importi+ grup	cope	1
F.V. WC allaturka importi+ kasete	cope	1
F.V. bolier 80 liter, uje te ngrohte + grup dushi	cope	1
FV Tub Ø 20 presioni	ml	67.00

FV rakorderi presioni	ton	0.015
F.V. Tub Ø 20 shkarkimi+rakorderi	ml	25.00
FV rakorderi plastike shkarkimi	kg	12.00
Tub shkarkimi pvc Ø 170 mm	ml	12.00
FV saracineska kryesore bronzi 1/2	cope	1.00

N.S - 4 A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtues.

Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria N.S - 4 A “Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese” konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to.

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punimeve prej druri, të dyerve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dyshemeve të tipeve të ndryshme dhe me materiale të ndryshme dhe të punimeve të realizuara me dorë, me metal, dru, material plastik dhe material xhami ose të ngjashëm.

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i izolimit termik dhe akustik, nënçatitë dhe mbrojtja nga zjarri, izolimi i natyrave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në zërat e preventivit për realizimin e punimeve të ndryshme ndërtimore, konkretisht për grup punimet si vijon:

Zerat dhe volumet sipas preventivit.

Punime dyer dhe dritare rifiniture		
F V dritare d/alumini plastike me dopio xham	m ²	53.40
F V dyer d/alumini plastike te jashtme me dopio xham	m ²	32.90
F V dyer d/alumini plastike te brendeshme me 1/2 xham	m ²	2.53
F.V. Dyer metalike llamarine	m ²	3.75
Shtrese me pllaka mermeri, 40x40cm	m ²	17.830
Suva e zakonshme fasade mur tulle+ xokol h ~ 8 m	m ²	535.00
Boje hidroplastike cilesi e larte	m ²	566.00
Veshje strehe me kartonxhez cimentato	m ²	30.60

N.S - 8 B Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri.

Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria N.S - 8 B “Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri” përfshin prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vepër të strukturave parafabrikate prej betoni të armuar, normal dhe të paranderur. Prodhimin në kantier dhe montimin në vepër të strukturave prej çeliku ose të fasadave të përbëra nga telajo metalike dhe elemente modulare prej xhami ose materiali tjetër. Prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vend të strukturave të përbëra nga elementë të drejtë të trajtuar përpara.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në zërat e preventivit për realizimin e punimeve të ndryshme ndërtimore, konkretisht për punimet si vijon:

Zerat dhe volumet sipas preventivit.

Ndertime parafabrikat me beton te armuar		
Struktura monolite betoni me çakell C 25/30, (betonim kanali dhe kapakët)	m ³	9.30
F.V. hekur betoni Ø 6 - 10 mm	ton	0.50
Struktura monolite betoni me çakell C 25/30, (betonim kanali dhe kapakët)	m ³	31.40
F.V. hekur betoni Ø 6 - 10 mm	ton	1.813
Struktura monolite betoni me çakell C 25/30, (betonim kanali dhe kapakët)	m ³	7.60
F.V. hekur betoni Ø 6 - 10 mm	ton	0.43
Shtrese betoni C12/15 t=10 cm	m ³	19.00
Struktura monolite betoni me çakell C 25/30, (betonim kanali dhe kapakët)	m ³	104.20
F.V. hekur betoni Ø 6 - 10 mm	ton	1.513
F.V. hekur betoni Ø > 10 mm	ton	9.133

N.S. – 12 A Impiante teknologjik, termik dhe te kondicionimit.

Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria N.S – 12, A “ Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit” Konsiderohen montimi dhe mirëmbajtja ose ristrukturimi i një sistemi të plotë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të klimës, të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme, të impianteve pneumatike, të kompletuara me punimet murature,

plotësuese ose ndihmëse, për të realizuar bashkimet ose ndërhyrjet që i përkasin kategorive të përgjithshme që janë realizuar ose janë në proces realizimi.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në zërat e preventivit për realizimin e punimeve të sistemit të kondicionimit HVAC konkretisht për punimet si vijon:

Zerat dhe volumet sipas preventivit.

Impiante teknologjik, termik dhe të kondicionimit		
F.V. Kondicionere inverter 24 BTU	cope	5
F.V. Kondicionere inverter 12 BTU	cope	1
F.V. Panel metalik IP65(700x550x250mm)	cope	1
F.V. Automat termo-elektro magnetik,4P;380V;100A	cope	1
F.V. Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 63A	cope	3
F.V. Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 16A	cope	36
F.V. Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 10A	cope	30
F.V. Çeles automat termo-elektro magnetik 2P;20A;220V	cope	6
F.V. Automat magneto-termik 380V,40A, 4P,Id=0.03A	cope	1
F.V. Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 10A	cope	3

N.S. - 13 A Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni TV.

Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria N.S. – 13, A Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave telefonike të jashtme dhe impiante të telekomunikacionit me frekuencë të lartë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të kompletuara me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për tu realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në zërat e preventivit për realizimin e punimeve të rrjetit të brendshëm telefonik, telekomunikacioni i transmetimit të të dhenave konkretisht për punimet si vijon:

Zerat dhe volumet sipas preventivit.

Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni TV		
F.V Rack, 19",15U W600xH770xD495	cope	1
F.V Kutiderivacioni plastm	cope	9

F.V. Kuti suport pllaket 2 mod	cope	11
F.V Prize interneti RJ45 CAT6a	cope	22
F.V tub plastmasi Ø 22-26mm	ml	330.00
F.V Kabell Interneti CAT6a SFTP	ml	330.00
F.V Koka Rrjeti CAT6a Metalike	cope	22
F.V Ventilator Rack me 3 Helika dhe termostat	cope	1
F.V Poliprize Racku me 8 Shuko, me Mbrojtje Tensioni, Kabell 2m, 1U	cope	1
F.V Patchpanel 24 x RJ45 shielded , CAT6a, 1 U	cope	1
F.V Ndricues LED Racku me magnet, 700 lm, me celes, 1U	cope	1
F.V Patch corde CAT6a, L=2m, RJ 45 , 10 GB	cope	24

N.S - 14 A Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV.

Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria N.S - 14 A “Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV”: Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të trasmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t’u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në zërat e preventivit për realizimin e punimeve të ndryshme, konkretisht për punimet si vijon:

Zerat dhe volumet sipas preventivit.

Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV		
F.V. Kuti suport pllaket 2 mod	cope	14
F.V. Kuti suport pllaket 4 mod	cope	4
F.V Çeles 1 polar 220V 10A	cope	21
F.V Çeles 2 polar 220V 10A	cope	10
F.V Tapa fallco	cope	15
F.V percjelles PV-500 Ø 1.5 mm2	ml	1260.00
F.V. Percjelles PV-500 Ø 2.5 mm2	ml	180.00

F.V. Tub plastmasi Ø 18-21mm	ml	350.00
F.V tub plastmasi Ø 22-26mm	ml	50.00
F.V Ndricues LED 40w, 60x60, 4000K, 20000 op, IP40	cope	41
F.V Ndricues LED 2x18w, 120cm, 4000K, 20000 op, IP40	cope	6
F.V Ndricues tavanor LED 24 W IP 65 4000 K	cope	8

Argumentimi lidhur me kërkesat e licencave profesionale në fushën e projektimit

3. PROJEKTUES KONSTRUKTOR

d- Vlerësimi i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse prej beton-arme, murature dhe metalike.

4. PROJEKTUES INSTALATOR

c- Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industrial.

10. PROJEKTIMI I IMPIANTEVE TË PRODHIMIT DHE SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE

d- Nënstacione elektrike, primare sekondare - linja të tensionit të lartë.

Në përputhje me natyrën dhe shkallën e vështirësisë teknike të punimeve të këtij objekti prokurimi është kërkuar zgjidhja sipas termit “Turn key” që përfshin rikonstruksionin dhe fuqizimin e N.Stacionit elektrike të Shpërndarjes me zgjidhjet dhe pajisjet me të fundit për këto projekte.

Realizimi i këtij projekti kërkon përfshirjen e stafit projektues në licencat e kompanisë të specializuar në fushën:

3. Projektues konstruktor

4. Projektues instalator

10. Projektimi i impianteve të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike

Konkretisht, kërkohet që dokumentacioni i ofertës të përfshijë licencat për këto kategori projektuesish:

3. Projektues konstruktor – d. Vlerësimi i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse prej beton-arme, murature dhe metalike.

Eshtë vlerësuar kërkesa për licencën drejtues teknik i kategorisë licencën "Projektues konstruktor – d. Vlerësimi i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse prej beton-arme, murature dhe metalike " sepse lidhet ngushtësisht me projektimin e strukturave mbajtëse si janë konstruksionet metalike të pajisjeve 110kV, rrufepritesat etj dhe objekteve

ndihmëse në nënstacione, duke garantuar siguri dhe stabilitet mekanik sipas normave të ndërtimit.

Per sa me siper projektuesi konstruktor është i nevojshëm per vlerësimin e kapacitetit mbajtës të bazamenteve dhe konstruksioneve metalike te rinj, mbi të cilat do të instalohen pajisje të reja elektrike. Gjithashtu, në rastet kur ngarkesat e reja ose kushtet e projektimit e kërkojnë, duhet të projektohen masat e nevojshme të përforsimit strukturor për të garantuar qëndrueshmërinë, sigurinë dhe funksionimin e besueshëm të ndertesës së nënstacionit gjatë gjithë jetës së tij në shërbim. Kjo licencë garanton që këto vlerësime dhe zgjidhje projektuese të kryhen nga një specialist i licencuar, në përputhje me legjislacionin dhe standardet teknike në fuqi.

Konkretisht ne projektin e këtij objekti kemi punime të cilat përfshijnë:

zëvendësimin dhe instalimin e transformatorëve të fuqisë.

montimin e pajisjeve të reja dhe impiantit shpërndarës të energjisë TM 35/20/6kV.

ndërtimin e bazamenteve të rinj dhe modifikimin dhe zgjerimin e ndertesës ekzistuese të N.Stacionit.

instalimin e konstruksioneve metalike, kanaleve të kablllove elektrike etj.

Në këto raste, vlerësimi i kapacitetit mbajtës është një pjesë thelbësore e projektimit për të garantuar që strukturat ekzistuese mund të përballojnë ngarkesat shtesë dhe veprimet sizmike sipas kërkesave të projektimit.

4. Projektues instalator – c. Projektim të linjave të rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale.

Kërkesa për licencën "Projektues instalator – c. Projektim të linjave të rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale" është vlerësuar e nevojshme pasi objekti i kontratës përfshin projektimin e instalimeve dhe rrjeteve elektrike në nënstacione elektrike, të cilat klasifikohen si objekte industriale. Projektimi përfshin rrjetet e furnizimit me energji, instalimet AC/DC, kabllot e fuqisë, kontroll komandimit, sistemet e ndriçimit, tokëzimit, mbrojtjes, matjes, si dhe lidhjen dhe integrimin e pajisjeve të reja me infrastrukturën ekzistuese të N.Stacionit, sidomos në fazën provizore që N.Stacioni do të jetë në punë dhe do të furnizojë konsumatorët e tij, por nderkohe do të kryhen punimet për kalimin në nivel tensioni 110kV të tij.

Kjo licencë garanton që projektimi të realizohet nga një specialist i licencuar, në përputhje me legjislacionin, standardet teknike dhe kërkesat e sigurisë në fuqi, duke siguruar funksionim të besueshëm dhe të sigurt të N.Stacionit.

Konkretisht ne projektin e këtij objekti kemi punime të cilat përfshijnë:

projektimin e kablllove të fuqisë, kontroll komandimit dhe fidera 20/6kV.

projektimin e rrjetit AC dhe DC të N.Stacionit;

projektimin e instalimeve të ndriçimit elektrik.

integrimin e sistemeve të mbrojtjes, automatizimit telekomunikacion dhe SCADA.

instalimin dhe veninen ne pune te transformatorëve te fuqise, rrjetit TM te shperndarjes se energjise elektrike etj

Në këto raste, kjo licencë është drejtpërdrejt e lidhur me objektin e projektimit dhe siguron që instalimet elektrike të nënstacionit të projektohen në mënyrë të sigurt, funksionale dhe në përputhje me standardet teknike në fuqi.

10. Projektimi i impianteve të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike – d për projektimin e linjave të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike që përbëjnë rrjetin primar dhe sekondar.

Kërkesa për licencën "Projektues për impiantet e shpërndarjes së energjisë elektrike – Pika 10/d: për projektimin e linjave të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike që përbëjnë rrjetin primar dhe sekondar" është vlerësuar e nevojshme pasi objekti i kontratës përfshin projektimin e N.Stacioneve elektrike dhe lidhjen e tyre me rrjetin elektroenergjetik ne nje nivle tensioni me te larte se ai ekzistues, ne 110kV.

Projektimi përfshin zgjidhjet teknike për linjat hyrëse dhe dalëse, lidhjet me rrjetin e transmetimit dhe ate te shpërndarjes se energjise, konfigurimin e skemave elektrike, koordinimin e pajisjeve primare TL, atyre TM dhe integrimin e tyre me rrjetin ekzistues. Kjo licencë garanton që projektimi të realizohet nga një projektues i licencuar, i afte në projektimin dhe llogaritjen e impianteve dhe rrjeteve të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, duke siguruar përputhshmërinë me standardet teknike, kërkesat e sigurisë dhe kushtet e operimit të sistemit elektroenergjetik.

Arsyet teknike pse është i nevojshem dhe punime qe jane pjese e ketij objekti, paraqiten si meposhte:

projektimi i N.Stacionit elektrik me nivel tensioni 110 kV, 35 kV, 20 kV ose nivele të tjera tensioni.

projektimi dhe llogaritja e skemave të primare TL/TM dhe ato sekondare te mbrojtje, kontroll, komandimi të N.Stacionit.

dimensionimi dhe konfigurimi i lidhjeve elektrike e pajisjeve, transformatorëve, zbarave dhe linjave elektrike TL/TM.

garantimi i sigurisë, selektivitetit, besueshmërisë dhe vazhdimësisë së furnizimit me energji elektrike.

Ky argumentim është plotësisht në përputhje me objektin e projektimit të nënstacioneve elektrike, pasi kjo kategori licence mbulon projektimin e impianteve dhe rrjeteve që përbëjnë pjesën kryesore të sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike.

Këto licenca përbëjnë gjithashtu pervecse një garanci teknike edhe ligjore që operatori ofertues ka kapacitetin profesional, ekspertizën e nevojshme dhe garanton realizimin e plote te projektimit sipas kerkesave te AK dhe ta zbatoje ate me sukses deri ne perfundimin e punimeve, per kete N.Stacion te rendesishem te Operatorit te Sistemit te Shperndarjes .

Gjithashtu, OE ofertues mund të kontraktoje disponuesit e këtyre licencave, nëse nuk janë pjesë e stafit të tij, me qëllim realizimin e kontratës.

Keto kategori projektimi janë në përputhje me zërat e preventivit paraprak dhe punimet përkatëse për objektin e prokurimit, këto janë proporcionale dhe të lidhura ngushtë me realizimin e punimeve, natyrën dhe vlerën e kontratës. Kjo kërkesë lidhur me licencën profesionale të shoqërisë është në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pika 6, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.3 Dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik:

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojnë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, të cilët duhet figurojnë në listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave si më poshtë:

Inxhinier Elektrik	1 (nje)
Inxhinier Ndërtimi	1 (një)
Inxhinier Mekanik	1 (një)

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

Kontratë pune,

Diplomën Universitare,

Libreze pune,

CV

Listpagesat E-Sig të shoqërisë.

Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, i ndryshuar, sa i takon ndalimeve të dy punësimit.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë staf teknik inxhinier (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë) dhe punonjës të specializuar/kualifikuar, si më poshtë :

Ing. Elektrik	2 (dy)
Ing. Elektronik	1 (një)
Teknik Ndërtimi	2 (dy)
Elektriciste	10 (dhjete)
Punetore ndertimi	10 (dhjete)
Punetore te thjeshte	10 (dhjete)

Për punonjësit me profesionet si më sipër (përfshirë inxhinierët) , operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë :

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1				
2				
3				
4				
5				

Për stafin teknik inxhinier si më sipër, ofertuesit duhet të paraqesin :

Kontratë pune,

Diplomën Universitare,

Libreze pune dhe CV.

Listpagesat E-Sig të shoqërisë.

Për teknikët e ndërtimit dhe elektrikistët:

Kontratën individuale të punës

Diplomën e shkollës së mesme profesionale përkatëse

Libreze pune.

Listpagesat E-Sig të shoqërisë.

Për punonjësit e ndërtimit dhe ata të thjeshtë ndihmes:

Kontratën individuale të punës;

Listpagesat E-Sig të shoqërisë.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentim 2.3.3 – a & b.

Kërkesat e shkronjave a) dhe b), të pikës 2.3.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim, janë bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, në nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.” dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Personeli i mësipërm është kërkuar në bazë të vlerësimit të preventivit dhe nevojave për realizimin e punimeve të këtij projekti.

Numri i inxhinierëve, specialistëve dhe punonjësve sipas profesioneve perkatese, është kërkuar duke vlerësuar rëndësinë e vecante që ka rikonstrukcioni dhe fuqizimi i këtij N.Stacioni elektrike të Shpërndarjes, duke qenë i rëndësishëm për qytetin e Tiranës, i rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, dhe do të kryhet në kushte pune dhe me tension, për të mos ndikuar në furnizimin me energji elektrike të konsumatorëve që ky furnizon, por që duke respektuar gjithmone rregullat e sigurimit teknik në maksimum, ta garantojë atë.

Numri i tyre në punimet e rikonstrukcionit, fuqizimit, punime montimi, demontimi civil, elektrike në ndertesat e N.Stacioneve është bazuar në zerat dhe volumet e parashikuar në punimet e preventivit si dhe grafikun e realizimit të projektit për arsye të mëposhtme:

Kërkesa që operatorët ekonomikë të disponojnë staf teknik inxhinierik (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë) dhe punonjës të specializuar/kualifikuar është vendosur në funksion të garantimit të realizimit të kontratës sipas kërkesave teknike, standardeve në fuqi dhe rregullave të sigurisë në punë. Duke qenë se objekti i kontratës përfshin punime në N.Stacione elektrike, instalimin dhe lidhjen e pajisjeve elektrike, montime elektromekanike, punime ndërtimore ndihmëse, teste dhe vënie në punë, është e domosdoshme që operatori ekonomik të disponojë personel me kualifikimin dhe eksperiencën e nevojshme për secilin proces të zbatimit.

Argumentimi sipas profileve:

2 (dy) Inxhinier Elektrik – për organizimin, mbikëqyrjen dhe koordinimin e punimeve elektrike, verifikimin e zbatimit të projektit, kryerjen e testimeve dhe vënien në punë të pajisjeve të nënstacionit, mbajtjen në punë të N.Stacionit ekzistues dhe shtrimin e linjes kabllorë 35kV nga N.Stacioni Kinostudio në shtyllën e parë ajrore të shkollës Rëna afër Linzes sipas projektit bashkelidhur në dokumentat teknike.

Prania e dy inxhinierëve garanton mbulimin e disa fronteve të punës njëkohësisht dhe eliminon vonesat gjatë realizimit të kontratës.

1 (një) Inxhinier Elektronik – për konfigurimin, integrimin dhe testimin e sistemeve të automatizimit, mbrojtjes, kontrollit, komunikimit dhe SCADA, telekomunikacion si dhe për verifikimin e funksionimit të pajisjeve elektronike dhe sistemeve ndihmëse.

2 (dy) Teknikë Ndërtimi – për ndjekjen e punimeve civile, kontrollin e zbatimit të bazamenteve, kanaleve të kablllove, konstruksioneve mbështetëse dhe elementëve të tjerë ndërtimorë, në përputhje me projektin dhe specifikimet teknike në dy fronte të ndryshme në distance, por në të njëjtën kohë.

2 (dy) Teknikë Ndërtimi janë të nevojshëm gjithashtu edhe për arsyet e mëposhtme:

organizimin e punimeve civile në N.Stacion;

kontrollin e zbatimit të projektit;

mbikëqyrjen e themeleve dhe strukturave;

kontrollin e cilësisë së betonimeve;

ndjekjen dhe realizimin e punimeve për kanalin e kabllit 35kV.

Dy teknikë mundësojnë kontroll të vazhdueshëm të punimeve pa ndërprerë ritmin e ndërtimit.

10 (dhjetë) Elektracistë – për kryerjen e montimit të pajisjeve elektrike, instalimin e kablllove të fuqisë dhe komandimit, realizimin e lidhjeve elektrike, montimin e sistemeve të tokëzimit, si dhe testimet elektrike gjatë zbatimit të kontratës.

10 (dhjetë) Elektracistë janë të nevojshëm sepse rikonstruksioni dhe fuqizimi i nënstacionit Kinostudio do të jetë në tension dhe gjendje pune gjatë gjithë kohës së punimeve, (përveç rasteve të ralla të doosdoshme) dhe përfshin një volum të madh punime, instalime, kabllime elektrike, por kërkon edhe siguri të lartë të punonjësve të tjerë operativë në proceset e mëposhtme:

instalimin e pajisjeve primare 110kV

lidhjet e pajisjeve TM, cela etj.

lidhjet e paneleve të mbrojtjes;

instalimin e kablllove të fuqisë TM/TU.

instalimin e kablllove të kontrollit;

lidhjen e qarqeve sekondare;

instalimin e sistemeve të tokëzimit;

montimin e ndriçimit;

instalimin e baterive dhe karikuesve;

instalimin e sistemeve AC/DC;

testimet elektrike.

Punimet realizohen njëkohësisht në nënstacion, por edhe shtrimi i linjes kabllore 35kV jashtë tij, ndaj kërkohet një numër i mjaftueshëm elektrikistësh për sigurinë e tyre, te punimeve dhe për të respektuar afatet e kontratës, për realizimin e saj.

10 (dhjetë) Punetore ndertimi – për kryerjen e punimeve ndertimore, murature, suvatim, hidrualik etj te cilat jane te domosdoshem per realizimin e punimeve sipas volumeve perkatese, afateve te realizimit, sigurine ne pune te tyre dhe per proceset e punes si meposhte:

gërmimeve, themeleve, betonimeve.

ndërtimit të kanaleve të kabllave TM, TU.

montimit të elementeve prej betoni

sistemimi i sheshit te N.Stacionit

rikonstruksioneve metalike te pajisjeve etj.

Punimet civile zhvillohen ne fazen pergatitore te sheshit te N.Stacionit, zgjerimi i nderteses ekzituese, vazhdon edhe paralelisht me montimin e pajisjeve elektrike, hapje kanal kablli 35kV, pra ne disa pune por edhe vendodhje te ndryshme ne distance nga njera tjetra dhe për këtë arsye eshte kerkuar ky numer punetore ndertimi.

10 (dhjetë) Punëtorë të thjeshtë ndihmës – për realizimin e punëve fizike dhe ato ndihmëse të montimit, transportit dhe sistemimit të materialeve, hapjen dhe mbylljen e kanaleve të kabllave, mbështetjen e proceseve të instalimit dhe punimeve të tjera ndihmëse të nevojshme për realizimin në kohë dhe sipas grafikut të punimeve, pa patur nevojë për kualifikim teknik.

Punëtorët e thjeshtë janë të domosdoshëm gjithashtu edhe për mbështetjen e teknikeve të ndërtimit, elektrikistëve në punët operative të të gjitha aktiviteteve në kantier si mëposhte:

ngarkimin dhe shkarkimin e materialeve,

transportin manual të pajisjeve,

asistencën gjatë montimit,

pastrimin dhe organizimin e kantierit,

sistemimin e materialeve,

mbështetjen e ekipeve të elektrikistëve dhe montatorëve;

vendosjen e sinjalistikës së përkohshme,

rehabilitimin e zonave të punës pas përfundimit të punimeve.

Ky staf është proporcional me objektin e kontratës dhe synon të sigurojë që punimet të realizohen në mënyrë të sigurt, cilësore dhe brenda afateve të përcaktuara, duke garantuar disponueshmërinë e punonjesve të nevojshme për kryerjen paralelisht të proceseve të ndryshme të punës në fuqizimin dhe rikonstruksionin e N.Stacionit elektrike.

c. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se kanë të punësuar në stafin e tyre 1 (një) punonjës i cili të plotësojë kërkesat dhe të disponojë çertifikatën si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10237 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

Kontratën e punës,

Dëshminë/certifikatën përkatëse.

Listpagesat E-Sig të shoqërisë.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentim 2.3.3 - c.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", të ndryshuar dhe në nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht :

Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë një Përgjegjës për Sigurinë dhe Mbrojtjen e Shëndetit në Punë, në përputhje me Ligjin Nr. 10237, datë 18.02.2010, "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", si dhe me VKM Nr. 312, datë 05.05.2010, "Për miratimin e Rregullores "Për sigurinë në kantier"", është e nevojshme pasi objekti i kontratës përfshin punime në nënstacione elektrike, të cilat klasifikohen si punime me rrezik të shtuar. Gjatë zbatimit të kontratës do të kryhen punime elektrike, montime elektromekanike, punime ndërtimore, ngritje dhe montim pajisjesh me mjete mekanike, si dhe testime dhe vënie në punë të pajisjeve, procese që shoqërohen me rrezik për jetën dhe shëndetin e punëmarrësve.

Prania e një personi përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë garanton identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve, hartimin dhe zbatimin e masave parandaluese, kontrollin e përdorimit të pajisjeve mbrojtëse personale, monitorimin e respektimit të procedurave të sigurisë, si dhe koordinimin e masave mbrojtëse gjatë gjithë periudhës së realizimit të kontratës.

Kjo kërkesë synon të minimizojë rrezikun e aksidenteve në punë, të mbrojë jetën dhe shëndetin e punonjësve dhe të sigurojë zbatimin e punimeve në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky argumentim është proporcional me natyrën e kontratës, pasi punimet në N.Stacione elektrike përfshijnë, ndër të tjera:

punime në afërsi të pajisjeve me tension të lartë dhe të mesëm;

instalimin dhe lidhjen e pajisjeve elektrike dhe elektromekanike;

përdorimin e vinçave dhe mjeteve ngritëse për montimin e pajisjeve të rënda, transformatore fuqie me peshe 60-80ton.

punime në lartësi dhe në ambiente me tension.

testime dhe vënie në punë të pajisjeve elektrike dhe sistemeve mbrojtje, kontroll komandimi.

Për këto arsye, kërkesa për një Përgjegjës për Sigurinë dhe Mbrojtjen e Shëndetit në Punë është e lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës, është e domosdoshme për garantimin e një mjedisi të sigurt pune dhe është në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Operatorët ekonomikë duhet që nga punonjësit e kërkuar më sipër, minimalisht punonjësit e kualifikuar si:

Ing Elektrik	2 (dy)
Ing Elektronik	1 (nje)
Ing Ndertimi	1 (nje)
Ing Mekanik	1 (nje)
Teknik Ndërtimi	2 (dy)
Elektracistë	10 (dhjete)
Punetoret e ndertimit	4 (kater)

duhet të jenë të pajisur me dëshminë përkatëse që vërteton kualifikimin nga OMVK te autorizuar në përputhje me kërkesat ose standardet ekuivalente sipas Rregullores së sigurimit dhe shfrytëzimit teknik për impiantet, pajisjet dhe instalimet elektrike.

Për këtë operatorët ekonomikë krahas dokumentacionit të kërkuar në pikën 2.3.3 (a/b), duhet të paraqesin edhe dëshminë përkatëse që vërteton kualifikimin OMVK.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentim 2.3.3 - d.

Numri i punonjesve te kualifikuar me lart eshte i nevojshem gjate gjithë periudhes se kryerjes se punimeve, per shkak te volumit te punimeve, pergatitjet per vendosjen e pajisjeve te reja transformatore fuqie dhe pajijse 110kV, lirimini e nje pjese te sheshit te N.Stacionit per krijimin e hapesires se nevojshme per ndertesën e re te N.Stacionit, vendosjen ne pune te celave TM, paneleve te mbrojtjes kontroll komandimit, dhe vendosjen e plote ne pune te N.Stacionit te fuqizuar me pajisjet e reja, duke minimizuar kohen e nderprerjeve te energjise ne rast nevoje. Pra jane shume procese pune ne te njejtën kohe, qe kerkojne grup pune me punonjes te kualifikuar per realizimin e tyre me sukses dhe kohen e duhur.

Kërkesa që minimalisht

Ing Elektrik	2 (dy)
Ing Elektronik	1 (nje)
Ing Ndertimi	1 (nje)
Ing Mekanik	1 (nje)
Teknik Ndërtimi	2 (dy)
Elektricitë	10 (dhjete)
Punetoret e ndertimit	4 (kater)

të jenë të pajisur me certifikata trajnimi ose deshmi kualifikimi të lëshuara nga një Organ i Miratuar i Vlerësimit të Konformitetit (OMVK) ose nga një institucion tjetër i autorizuar sipas legjislacionit në fuqi, që vërtetojnë kompetencën e tyre për kryerjen e punimeve përkatëse është e nevojshme pasi objekti i kontratës përfshin punime në N.Stacione elektrike, të cilat konsiderohen punime me rrezik të lartë për shkak të pranisë së instalimeve me nivel tensioni TL/TM, pajisjeve elektrike dhe proceseve të montimit, testimit dhe vënies në punë. Personeli që kryen këto punime duhet të ketë njohuritë dhe kompetencat e verifikuara nga një organ i autorizuar, për të garantuar zbatimin korrekt të rregullave teknike, procedurave të sigurisë dhe masave për mbrojtjen e shëndetit në punë.

Pajisja e personelit me certifikata të lëshuara nga një OMVK siguron që aftësitë profesionale dhe njohuritë e tyre janë vlerësuar nga një subjekt kompetent dhe i miratuar sipas legjislacionit në fuqi, duke ulur rrezikun e aksidenteve gjatë punimeve, duke garantuar cilësinë e zbatimit të kontratës dhe respektimin e kërkesave ligjore e teknike për punimet në objekte të infrastrukturës kritike elektroenergjetike.

Operatorët ekonomikë ofertues duhet duhet të vërtetojnë se kanë të punësuar në stafin e tyre ose të kontraktuar me kontratë shërbimi 1 (një) Inxhinier të certifikuar nga prodhuesi, distributori i autorizuar i tij ose ekuivalentet e tyre për instalimin dhe komisionimin e Sistemeve DGA & BMT.

Lidhur me këtë pike operatori ekonomik ofertues në rastin se e ka pjesë të stafit inxhinierin e kërkuar, duhet te paraqesë:

Kontrata e punës

Liste pagesat. E-Sig

Certifikata përkatëse të Inxhinierit të certifikuar nga prodhuesi i pajisjeve ose Distributori i autorizuar i tyre ose ekuivalentet e tyre.

Në rast se disponon kontratë shërbimi operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

Kontratën e shërbimit

Certifikata përkatëse të Inxhinierit të certifikuar nga prodhuesi i pajisjeve ose Distributori i autorizuar i tyre ose ekuivalentet e tyre.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentim 2.3.3 - e.

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Drejtoria e Tensionit të Lartë OSSH SH.A, duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një 1 (një) inxhinier elektrik të certifikuar nga prodhuesi ose distributor i tij i autorizuar për sistemet DGA dhe BMT duke qenë që diagnostikojnë, analizojnë dhe monitorojnë pajisjen me të rëndësishme dhe me të shtrenjta të N.Stacioni elektrike.

Sistemet DGA & BMT analizojnë gazrat e tretur dhe matjen e lagështisë në vajin e transformatoreve të fuqisë dhe monitorimin e izolacionit në izolatorët kalimtarë 110 kV dhe shkarkimet pjesore PD, dhe njihet si një test i rëndësishëm për vlerësimin e gjendjes së transformatorëve fuqisë, me izolacion të peshtjellave në vaj, si janë edhe transformatorët në N. Stacionet elektrike të Shpërndarjes.

Sistemet DGA & BMT ofrojnë diagnostikim, analizim, të detajuara online për clirimin e gazrave në vajin e transformatorit të fuqisë, monitorojnë izolacionin në izolatorët kalimtarë 110kV dhe regjistrojnë dhe sinjalizojnë të dhenat teknike të monitoruara.

Ky sistem duhet të jetë i aftë për tu integruar me sistemin qendror të monitorimit për të dy proceset, në OSSH qendrore në mënyrë që të sinjalizojë gjendjen reale të transformatorit.

Gazrat e cliruar në vajin e transformatoreve të fuqisë dhe tap changer të tyre.

Izolacioni i izolatoreve kalimtarë 110kV në transformatorët e fuqisë.

Teorikisht analizimi i gazrave të ciluar në vajin e transformatorit të fuqisë dhe monitorimi i izolacionit në izolatorët 110kV ndikojnë realisht në jetëgjatësinë e pajisjes me kryesore të N.Stacioneve elektrike si janë transformatorët e fuqisë.

Kjo pajisje kërkon konfigurim, parametrizim dhe përshtatje softëare-i me të dhënat teknike të transformatorëve që do të monitorohen. Për këtë arsye, është e domosdoshme që operatori ekonomik të disponojë një inxhinier elektrik të certifikuar nga prodhuesi (ose ekuivalent), i cili ka njohuritë teknike për të:

konfiguruar sistemin sipas specifikimeve të pajisjes dhe kërkesave të autoritetit kontraktor;

programuar dhe përshtatur softëare-in e analizës online të gazrave me parametrat e funksionimit të transformatorëve ekzistues;

verifikuar saktësinë e matjeve dhe analizave të gazrave, për të garantuar që pajisja do të japë rezultate të besueshme;

programuar dhe përshtatur softëare-in e monitorimit online për izolacionin e izolatoreve kalimtar 110kV dhe shkarkimet e pjeshme në ato.

siguruar funksionimin e qëndrueshëm dhe të sigurt të sistemit në mjedisin e punës së autoritetit kontraktor;

trajnim të specialisteve për përdorim dhe mirëmbajtje, në përputhje me udhëzimet e prodhuesit.

Ky veprim siguron që pajisja të funksionojë në mënyrë korrekte, të ofrojë matje dhe analiza të sakta, si dhe të garantojë përdorim të sigurt dhe jetëgjatësi të sistemit të monitorimit.

Prandaj, kërkesa për inxhinier elektrik të certifikuar nuk lidhet me një kontratë pune, por është një kërkesë teknike për të garantuar që furnizimi të shoqërohet me asistencën profesionale të nevojshme për vënien në punë dhe konfigurimin e saktë të pajisjes për nevoja operationale të autoritetit kontraktor.

Operatori ekonomik (në bazë të VKM 312 Dt.05.05.2010 për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier) duhet të vërtetojë që minimalisht 4 nga punonjësit e kërkuar të jenë të trajnuar dhe të pajisur me certifikata të punimeve në lartësi të lëshuara nga shoqëri të licencuara nga ministria përkatëse, të cilët të rezultojnë në listë pagesat e shoqërisë të paktën për 3 (tre) muajt e fundit duke marrë reference datën e hapjes së tenderit.

Për këta punonjës operatorët ekonomikë krahas dokumentacionit të kërkuar në pikën 2.3.3 b), duhet të paraqesin certifikatën përkatëse të punimeve në lartësi

Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

Kontrata e punës

Liste pagesat. E-Sig

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentim 2.3.3 - f

Numri i ketyre punonjesve është i nevojshëm për përpunimin, prerjen, bashkimin dhe montimin e konstruksioneve metalike te pajisjeve TL 110kV si dhe per montimin e rrufepritesave ne lartesine e parashikur dhe te nevojshme mbrojtje e zones se N.Stacionit, sipas zërave të preventivit të punimeve.

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të dëshmojnë se kanë të punësuar në stafin e shoqërisë punonjës të kualifikuar, të pajisur me Dëshmi të Aftësive Profesionale (DAP), lëshuar nga D.P.SH.T.RR., minimalisht si më poshtë :

Automakinist te mjeteve te renda / manovrator 1 (nje)

(Në rastet kur mjetet/makineritë dispononohen me qera, këta punonjës mund të jenë të kontraktuar).

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

Kontratat e punës të vlefshme;

Dokument (dëshmi kualifikimi profesional), që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

Liste pagesat. E-Sig

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi 2.3.3 - g.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe në nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, si dhe bazuar në rregulloren “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë minimalisht 1 (një) automakinist të mjeteve të rënda/manovrator, të pajisur me Dëshmi të Aftësive Profesionale (DAP) të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), është e nevojshme pasi objekti i kontratës përfshin transportin, manovrimin, shkarkimin, pozicionimin dhe montimin e pajisjeve të rënda në N.Stacione elektrike, si transformatorë fuqie i cili mund të peshoje nga 60-80ton, spostimin e transformatoreve ekzistues, pajisje TL 110kV, panele TM/TU, konstruksione metalike, barabane me kablllo fuqie dhe pajisje të tjera.

Kryerja e këtyre operacioneve kërkon përdorimin e mjeteve të rënda dhe pajisjeve ngritëse, të cilat duhet të operohen nga personel i kualifikuar dhe i pajisur me DAP, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kjo garanton që manovrimi i mjeteve të kryhet në mënyrë të sigurt, duke minimizuar rrezikun e aksidenteve, dëmtimit të pajisjeve dhe ndërprerjeve të panevojshme të punës, si dhe duke siguruar mbrojtjen e punonjësve dhe të infrastrukturës elektroenergjetike.

Kërkesa është në përputhje me natyrën e kontratës dhe respekton parimin e proporcionalitetit, pasi parashikon vetëm 1 (një) automakinist të kualifikuar, numër i mjaftueshëm për operimin e mjeteve të rënda gjatë fazave të transportit, manovrimit dhe montimit të pajisjeve në kantier.

Ky argumentim lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës, pasi në punimet në nënstacione elektrike përdorimi i mjeteve të rënda për transport dhe montim është një proces i domosdoshëm, dhe drejtimi i tyre duhet të kryhet nga operatorë që zotërojnë Dëshminë e Aftësive Profesionale (DAP) sipas kërkesave të legjislacionit shqiptar.

2.3.4 Të gjithë punonjësit e kërkuar sipas pikës 2.3.3, duhet të jenë në listpagesat e shoqërisë, për periudhën Maj - Korrik 2026. Përfshirë nga kjo bën punonjësi i kualifikuar si (Automakinist), i kërkuar sipas gërmës “g”, i cili përveç se si pjesë të stafit të ofertuesit (në listpagesat e tij) mund të jetë me kontratë shërbimi, vetëm në rastet kur mjetet/makineritë dispononohen me qera.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK, dokumentacionin si më poshtë :

Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Maj - Korrik 2026.

Argumentimi 2.3.4

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe në nenin 39, pika 6/ç), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore si pjesë të përvojës së shoqërisë, përvojë kjo e nevojshme për ekzekutimin e kontratës objekt prokurimit, pasi fakti që shoqëria disponon personel të kualifikuar në

vijimësi, tregon aftësi të larta profesionale dhe mundësi të mira për organizimin e punës dhe zbatimin me sukses të kontratave që do të lidhen gjatë zbatimit të MK.

Kriteri sipas pikës 2.3.4, të kapacitetit teknik, ku kërkohet që punonjësit të jenë pjesë e shoqërisë për një periudhë tre mujore, vlerësohet në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit dhe në funksin të përzgjedhjes së OE që zotërojnë aftësinë teknike dhe profesionale për zbatimin e kontratës.

2.3.5 Operatorët ekonomikë ofertues duhet të plotësojnë dhe të dorëzojnë së bashku me dokumentet e tjera, skedën teknike për artikujt me emërtesën e artikullit në të cilën duhet të deklarojnë të dhënat e kërkuara, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Emërtimi i artikullit	Kompania Prodhuese e artikullit të ofruar	Referenca për specifikimet teknike sipas katalogëve të artikullit të ofruar
1.	Transformator fuqie 115/20.8/6kV, 40/50MVA, ONAN/ONAF. (sipas specifikimeve teknike ne Relacion)		
2.	Sistem DGA (sipas specifikimeve teknike ne Relacion)		
3.	Sistem BMT (sipas specifikimeve teknike ne Relacion)		
4.	Çeles fuqie 110kV. (sipas specifikimeve teknike ne Relacion)		
5.	Ndares fuqie 110kV. (sipas specifikimeve teknike ne Relacion)		
6.	Transformator rryme 110kV. (sipas specifikimeve teknike ne Relacion)		
7.	Transformator tensioni 110kV. (sipas specifikimeve teknike ne Relacion)		
8.	Shkarkues 110kV dhe TM. (sipas specifikimeve teknike ne Relacion)		
9.	Panele mbrojtje / kontrolli (sipas specifikimeve teknike ne Relacion)		
10.	Çela te brendshme 35/20kV per N.Stacione. (sipas specifikimeve teknike ne Relacion)		

11.	Panele AC/DC dhe salle baterie (sipas specifikimeve teknike ne Relacion)		
12.	Sistemi SCADA (sipas specifikimeve teknike ne Relacion)		
13.	Sistemi Telekomunikacion (sipas specifikimeve teknike ne Relacion)		
14.	Kablo fuqie TM (sipas specifikimeve teknike ne Relacion)		
15.	Terminale TM (sipas specifikimeve teknike ne Relacion)		
16.	Xhunto TM (sipas specifikimeve teknike ne Relacion)		

Argumentimi 2.3.5

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 6/b, të nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të kësaj skede Autoriteti Kontraktor orienton ofertuesit të evidentojnë produktet e ofruara dhe e lidhur

me kërkesat e tjera për kualifikim në vijim, AK garantohet për cilësinë e produkteve të ofruara dhe faktin se oferta teknike është bazuar në produkte reale që plotësojnë specifikimet teknike të kërkuesit.

2.3.6 Operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin Autorizim të prodhuesit/Distributorit të autorizuar. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, uebfaqe, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, për listën e mallrave të mëposhtëm:

Transformatori i Fuqisë 110/20/6 kV

Sistem DGA për transformatorin e fuqisë

Sistem BMT për izolatorët kalimtarë në transformatorin e fuqisë

Çelës fuqie 110 kV

Ndarësi fuqie 110 kV

Transformator Rryme 110 kV

Transformator Tensioni 110 kV

Shkarkues 110 kV

Panele kontroll/mbrojtje

Çelat TM

Panele AC/DC dhe Salla Baterie

Sistemi SCADA

Sistemi Telekomunikacion

Kabllo fuqie TM

Terminale TM

Xhunto TM

Argumentim 2.3.6.

Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet SSH/IEC/DIN/EN.

Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë

23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3.7 Operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin dëshmi të Test Raporteve për materialet/pajisjet e ofruara sipas listës së mëposhtëme, të vlefshme të lëshuara nga prodhuesi/distributori i autorizuar, nga institucione të autorizuara ose ekuivalente të tyre. Këto dokumente duhet të vërtetojnë pajtueshmërinë e materialeve të ofruara me kërkesat teknike dhe standardet e të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Transformatori i Fuqisë 110/20/6 kV

Sistem DGA për transformatorin e fuqisë

Sistem BMT për izolatorët kalimtare në transformatorin e fuqisë

Çelës fuqie 110 kV

Ndarësi fuqie 110 kV

Transformator Rryme 110 kV

Transformator Tensioni 110 kV

Shkarkues 110 kV

Panele kontroll/mbrojtje

Çelat TM

Kabllo fuqie TM

Terminale TM

Xhunto TM

Argumentim 2.3.7.

Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues të paraqesë pajisje dhe materiale, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Duke marrë parasysh që e gjithë lista e kërkuar përbehet nga pajisje të vecanta që përdoren në N/stacione elektrike, kërkohej nga prodhuesi që të dëshmojë se është prodhues i certifikuar nga institucione ndërkombëtare sipas standarteve IEC/EN/SSH dhe pajisjet kanë kryer testimet e kërkuara, testet tip ose rutine nga prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me pikën 6/b, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

Kërkesa që operatorët ekonomikë ofertues të paraqesin dëshmi të testimeve zyrtare për materialet dhe pajisjet e ofruara është e nevojshme për të verifikuar përputhshmërinë e tyre me specifikimet teknike, standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të zbatueshme, si dhe me kërkesat funksionale të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Duke qenë se objekti i kontratës përfshin furnizimin dhe instalimin e pajisjeve që do të përdoren në N.Stacione elektrike, të cilat janë pjesë rrjetit elektroenergjitik shqiptarë, është e domosdoshme që pajisjet e ofruara të kenë

kaluar testimet përkatëse dhe të provohet se plotësojnë kërkesat e sigurisë, performancës, besueshmërisë dhe jetëgjatësisë.

Dëshmitë e testimeve, të lëshuara nga prodhuesi, distributori i autorizuar ose nga institucione të autorizuar ose ekuivalente të tyre, shërbejnë si provë objektive se materialet dhe pajisjet janë testuar sipas standardeve teknike përkatëse dhe se rezultatet e tyre janë në përputhje me parametrat e kërkuar. Kjo i mundëson autoritetit kontraktor të verifikojë, në fazën e vlerësimit të ofertave, se produktet e ofruara janë të përshtatshme për përdorim në rrjetin elektroenergjetik dhe se nuk krijojnë rrezik për sigurinë, funksionimin dhe vazhdimësinë e furnizimit me energji elektrike.

Kjo kërkesë është në përputhje me parimin e proporcionalitetit, pasi nuk kufizon burimin e dokumentacionit vetëm tek prodhuesi, por lejon edhe dokumente të lëshuara nga distributori i autorizuar ose institucione të autorizuar ose ekuivalente të tyre, duke garantuar njëkohësisht konkurrencën dhe verifikimin objektiv të cilësisë dhe konformitetit të materialeve dhe pajisjeve të ofruara.

2.3.8 Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Katalog/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/për listën e materialeve sipas skedës teknike që do të ofrohen, në të cilën të paraqiten të dhënat teknike bazë.

Shënim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qarte që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.

Argumentim 2.3.8

Kërkesa për paraqitjen e katalogut/ëve është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar, si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi.

Kërkesa që operatori ekonomik ofertues të paraqesë katalogët ose fragmente të katalogëve të prodhuesit për materialet dhe pajisjet e ofruara është e nevojshme për të mundësuar verifikimin objektiv të karakteristikave teknike të pajisjeve, produkteve dhe përputhshmërisë së tyre me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Katalogët teknikë përbëjnë dokumentacionin zyrtar të prodhuesit, në të cilin pasqyrohen parametrat teknikë, karakteristikat funksionale, dimensionet, performanca, standardet e zbatueshme dhe të dhëna të tjera të nevojshme për vlerësimin e ofertës.

Paraqitja e këtij dokumentacioni i mundëson autoritetit kontraktor të kryejë një verifikim të qartë dhe të paanshëm të përputhshmërisë së pajisjeve të ofruara me kërkesat e specifikimeve teknike, duke shmangur paqartësitë dhe duke siguruar që produktet e propozuara janë të përshtatshme për përdorim në nënstacionet elektrike. Gjithashtu, katalogët teknikë shërbejnë si bazë për identifikimin e modelit të ofruar dhe për verifikimin e parametrave të deklaruar nga ofertuesi.

Kjo kërkesë është në përputhje me parimet e transparencës, trajtimit të barabartë dhe proporcionalitetit, pasi u kërkohet të gjithë operatorëve ekonomikë të paraqesin dokumentacionin teknik zyrtar të prodhuesit për materialet që ofrojnë, duke krijuar kushte të barabarta për vlerësimin teknik të ofertave dhe duke garantuar që pajisjet e përzgjedhura plotësojnë kërkesat funksionale, të cilësisë dhe të sigurisë të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2.3.9 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës :

Nr.	Përshkrimi i mjetit	Sasia
1.	Makineri auto vetshkarkues me kapacitet mbajtes mbi 10 ton	1 copë
2.	Vinc jo me te vogel se 150 ton	1 copë
3.	Fadrome	1 copë
4.	Ekskavator me Goma	1 cope
5.	Ekskavator me Zinxhire	1 cope
6.	Minifadrome	1 cope
7.	Pick Up per transport stafi teknik dhe materialesh ne kantier	1 cope
8.	Kamion me vinc	1 cope
9.	Rrul Ngjeshes	1 cope
10.	Autobetoniere	1 cope
11.	Autopompe Betoni	1 cope
12.	Zyre te levizshme	1 cope
13.	Rimorkiator per transportin e makinerive te renda	1 cope
14.	Depozite uji 5000 lt	1 cope
15.	Elektrosaldatrice	1 cope
16.	Gjenerator	1 cope

Ofertuesi për të gjitha makineritë e mesiperme, të cilat janë në pronësi ose me qera, duhet të paraqesë, dokumentacionin e mëposhtëm :

Për mjetet që janë në pronësi, duhet të paraqitet :

- dokumenti që vërteton pronësinë (çertifikatën e pronësisë së mjetit rrugor);
- dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);

-
- c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik
 - d) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
 - e) leje transporti nga njësia vendore (sipas rastit);
 - f) foto të mjetit ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij.

Kur janë me qera, duhet të paraqitet :

- a) kontrata e qerasë;
- b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
- c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik
- d) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- e) leje transporti nga njësia vendore (sipas rastit);
- f) foto të mjetit ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij.

Për mjetet apo pajisjet e tjera që nuk pajisen me leje qarkullimi, ofertuesi duhet të paraqesë kontratë noteriale të blerjes ose fatura tatimore të blerjes ose dokument zhdoganimi të mjetit dhe foto të tyre.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi 2.3.9.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe në nenin 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Mjetet dhe pajisjet e kërkuara janë vendosur në proporcion me zërat dhe volumet e punimeve dhe afatin e përlogaritur për realizimin e kontratës objekt prokurimi.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronesi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i’u referuar punimeve sipas standardeve, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative,

makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

Mjetet dhe pajisjet si më sipër kërkohen referuar zërave të preventivit të punimeve.

Konkretisht mjetet dhe pajisjet e kërkuara, janë si më poshtë :

Pajisjet e mesiperme janë kërkuar si domosdoshmeri për realizimin e punimeve në rikonstruksionin dhe fuqizimin e këtij N.Stacioni, të cilat u referohen edhe zërave të punimeve që do të kryehen, materiale që do të transportohen si më poshtë:

Makineri auto vetshkarkues me kapacitet mbajtes mbi 10 ton.

Janë makineri që do të përdoren për shkarkimin si të pajisjeve elektrike 110kV si çelës, ndaresa, transformator rryme 110kV, cila TM 20kV, panele mbrojtje, kontroll komandimi, kabllot elektrike fuqie, kontrolli, TU, materialet elektrike etj.

Vinç jo më të vogël se 150 ton.

Është kushtë i domosdoshëm makineria e kërkuar vinç deri në 150 ton, sepse transformatori i ri i fuqisë 110/20/6kV. 40/50MVA mund të jetë me peshë totale nga 60-80 ton, dhe për ulje/ngritjen e tij është i nevojshëm vinçi me kapacitetin e kërkuar për shkak edhe të hapsirave në një N.Stacion elektrik që është në kushtë pune.

Pajisjet dhe makineritë e tjera si më poshtë:

Makineri auto vetshkarkues me kapacitet mbajtes mbi 10 ton

Vinç jo më të vogël se 150 ton

Fadrome

Eskavator me gomë

Eskavator me zinxhir

Minifadrome

Pick Up për transport stafi teknik dhe materiale në kantiere

Kamion me vinç

Rimorkiator për transportin e makinerive të rënda

Rrull Ngjeshës

Autobetoniere

Autopompe Betoni

Zyre të levishme

Depozite uji 5000 lt

Elektrosaldatrice

Gjenerator

Jane kusht i domosdoshem per realizimin e te gjitha punimeve si ndertimore, konstruksioneve metalike, transportimin e materialeve dhe pajisjeve te N.Stacionit por edhe per realizimin e punimeve sipas zerave ne preventivin e ketij projekti dhe grafikut te realizimit te punimeve te percaktuar per kete objekt makinerite dhe mjetet e punes te kerkuara.

Makineri auto-vetëshkarkuese me kapacitet mbajtës mbi 10 ton – për transportin dhe shkarkimin e materialeve inerte, dherave dhe materialeve të tjera të nevojshme për realizimin e punimeve në kantierin e Nënstacionit të Kinostudios.

Vinç me kapacitet ngritës jo më të vogël se 150 ton – për ngritjen, transportimin dhe pozicionimin e pajisjeve të rënda të nënstacionit, si transformatorë fuqie, pajisje të tensionit të lartë dhe elementë të tjerë të rëndë gjatë montimit.

Fadromë – për gjërmim, ngarkim dhe zhvendosje të dheut, inertëve dhe materialeve të ndërtimit.

Eskavator me goma – për gjërmime dhe hapje kanalesh në zona ku kërkohet lëvizje e shpejtë brenda ose midis zonave të kantierit.

Eskavator me zinxhir – për gjërmime të thella, terrene të vështira dhe punime me ngarkesë të rëndë.

Minifadromë – për transport dhe sistemim materialesh në zona të ngushta.

Pick-up për staf teknik dhe materiale – për transport të personelit, veglave dhe materialeve të lehta në kantier.

Kamion me vinç – për ngritje dhe vendosje të pajisjeve/materialeve të rënda.

Rimorkiator për makineri të rënda – për transportin e makinerive nga një objekt në tjetrin ose brenda kantierit.

Rrul ngjeshës – për ngjeshjen e dheut, zhavorrit ne rruget e brendshme te raj dhe shtresave të bazamentit.

Autobetoniere – për furnizim dhe transport të betonit të gatshëm.

Autopompë betoni – për pompimin dhe hedhjen e betonit në themele, mure ose struktura ku nuk arrihet direkt.

Zyra të lëvizshme – për administrimin teknik, mbikëqyrjen, dokumentacionin dhe organizimin e kantierit.

Depozitë uji 5000 L – për furnizim me ujë për betonime, pastrim dhe nevoja teknike të kantierit.

Elektrosaldatrice – për saldime metalike dhe montim strukturash.

Gjenerator – për furnizim me energji elektrike të pajisjeve dhe ndriçimit kur mungon rrjeti ose si rezervë.

2.3.10 Operatori Ekonomik Ofertues duhet të provojë se disponon pajisjet në pronesi ose me kontratë qeraje, me afat kohezgjatje për të gjithë kohën e vazhdimësisë së kontratës, pajisjet për instalimin e transformatorit të fuqisë si më poshtë:

Makineri për trajtimin e vajit me kapacitet 9000 L/H me tregues për prezencën e H₂O në vaj.

Kenotron për testimin e izolacionit të shpimit të vajit deri në 100kV.

Testues i lageshtirës dhe nivelit të H₂ në vaj.

Mikro ohm meter 100 A me certifikatë kalibrimi.

Terra ohm meter 10kV me certifikatë kalibrimi.

Analizator peshtjellash, koeficient transformimi, grup lidhje, rezistenca ohmike e peshtjellave me certifikatë kalibrimi.

Testues për rregullatorin e tensionin nën ngarkesë (OLTC) me certifikatë kalibrimi.

Pajisjet duhet të jetë i pajisur me dokumentacion perkates sipas legjislacionit në fuqi.

Për të përmbushur kriteret e mësipërme në fazën e ofertimit, operatori ekonomik duhet deklarojë disponimin e makinave në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentim: 2.3.10.

Lidhur me kërkesën e mësipërme për pajisjet e disponueshme, janë të nevojshme për kryerjen e të gjitha procedurave të sipercituara, realizimin dhe vënien në punë, në kohën e nevojshme me të shkurter të mundur, dhe duke qenë se zëvendësohet një pajisje që është në punë. Përshkrimi i punës, procesit të kryer nga secila makineri përshkruhet shkurtimisht më poshtë:

Makineria për trajtimin e vajit me kapacitet 9000L/H

Përdoret për filtrimin, degazimin dhe tharjen e vajit izolues të transformatorit gjatë montimit.

Hiqen lagështira, gazrat e tretur dhe papastërtitë që ndikojnë në forcën dielektrike të vajit.

Treguesi i H₂O siguron kontroll të vazhdueshëm për të shmangur prishje të izolimit.

Kenotron për testimin e izolacionit të vajit (deri 100 kV)

Shërben për të matur tensionin e shpimit (dielectric breakdown voltage) të vajit.

Siguron që vaji i mbushjes së transformatorit ka veti izolante të mjaftueshme përpara se transformatori të vihet në punë.

Testues i lagështirës dhe nivelit të H₂ në vaj

Analizon praninë e ujit dhe hidrogjenit të tretur në vaj.

Hidrogjeni është tregues i hershëm i defekteve të brendshme (si shkëndija ose mbinxehja).

Siguron që transformatori është i pastër dhe i shëndetshëm përpara energjizimit.

Mikro-ohm metër 100 A

Përdoret për të matur rezistencën e kontaktit në lidhjet e fuqisë (busbarë, terminale, ndërprerës, nyje).

Zbulon lidhje të dobëta ose të papastra, të cilat mund të shkaktojnë mbinxehje gjatë punës.

Terra ohm meter 10 kV

Teston rezistencën e izolimit ndërmjet pështjellave dhe tokëzimit.

Siguron që izolimi i transformatorit dhe aksesorëve të tij (kabllo, izolatorë) është brenda vlerave të pranueshme për tensionin e punës.

Analizator i pështjellave (koeficient transformimi, grup lidhje, rezistencë ohmike)

Kontrollon raportin e transformimit që duhet të përputhet me projektin.

Verifikon grupin e lidhjes së pështjellave sipas kërkesave të rrjetit.

Mat rezistencën e pështjellave, duke zbuluar anomali si qark i shkurtër në spirale ose lidhje jo të barabarta.

Testues për rregullatorin e tensionin nën ngarkesë (OLTC) me certifikatë kalibrimi.

Kontrollon funksionimin e rregullatorit të tensionit OLTC përpara energjizimit të transformatorit për të siguruar që nuk ka asnjë problem gjatë energjizimit.

Teston koeficientin e transformimit për çdo shkallë të OLTC

Me këto pajisje, bëhen testet e pranimit në vend (site acceptance tests – SAT), si dhe sigurohet që transformatori është i pastër, i thatë, i lidhur siç duhet dhe i sigurt për energjizim.

Lidhur me kërkesën e mesipërme për pajisjet e disponueshme, janë të nevojshme për kryerjen e të gjitha procedurave të sipërcituara, realizimin dhe vënien në punë, në kohën e nevojshme me të shkurter të mundur, dhe duke qenë se zëvendësohet një pajisje që është në punë.

2.3.11 Operatorët ekonomik ofertues që do të realizojnë këtë kontratë, duhet të jenë të pajisur dhe të paraqesin certifikatat përkatëse të vlefshme ose ekuivalentet e tyre, të lëshuara nga

organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, SSH EN ISO si me poshtë:

Certifikatë SSH EN ISO 9001:2015 ose ekuivalente mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim;

Certifikatë SSH EN ISO 45001:2023 ose ekuivalente mbi “Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në punë” lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim;

Çertifikatë SSH EN ISO 50001:2018 ose ekuivalente mbi “Standart për Menaxhimin e Energjisë”, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim.

Certifikatën SSH EN ISO 27001:2023, ose ekuivalente mbi “Standart për sistemin e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit”, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim.

Çertifikatë SSH EN ISO 14001:2015 ose ekuivalente mbi “Sistemin e menaxhimit të mjedisit”, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim.

Certifikatat si më sipër duhet të paraqiten origjinale ose kopje të noterizuara, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën SSH ose ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Argumentimi 2.3.11.

“Argumentimi për secilën certifikatë:

SSH EN ISO 9001:2015 ose ekuivalente – Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë.

Kjo certifikatë kërkohet për të garantuar që operatori ekonomik disponon një sistem të menaxhimit të cilësisë, i cili siguron planifikimin, kontrollin dhe monitorimin e proceseve të projektimit, furnizimit, instalimit, testimit dhe vënies në punë të pajisjeve. Zbatimi i këtij standardi kontribuon në ofrimin e produkteve dhe shërbimeve që përmbushin vazhdimisht kërkesat teknike dhe kontraktuale, duke minimizuar rrezikun e cilësisë së pajisjeve të ofruara për realizimin e kontratës.

SSH EN ISO 45001:2023 ose ekuivalente – Sistemi i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë.

Kjo certifikatë është e nevojshme pasi punimet do të kryhen në nënstacione elektrike, ku ekzistojnë rreze të konsiderueshme nga energjia elektrike, pajisjet nën tension, punimet në lartësi, ngritja e pajisjeve të rënda dhe përdorimi i makinerive. Standardi garanton që operatori ekonomik ka implementuar procedurë për identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin e rrezeve, duke mbrojtur shëndetin dhe sigurinë e punonjësve dhe të personave të tretë gjatë realizimit të kontratës.

SSH EN ISO 50001:2018 ose ekuivalente – Sistemi i Menaxhimit të Energjisë.

Kjo certifikatë kërkohet duke marrë në konsideratë natyrën e objektit të kontratës, e cila lidhet drejtpërdrejt me sistemin elektroenergjetik. Zbatimi i këtij standardi demonstroi se operatori ekonomik aplikoi praktika të menaxhimit efikas të energjisë, optimizon përdorimin e burimeve energjetike gjatë proceseve të projektimit dhe zbatimit të kontratës dhe kontribuon në realizimin e zgjidhjeve teknike me efikasitet energjetik, në përputhje me praktikën bashkëkohore dhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.

SSH EN ISO 27001:2023 ose ekuivalente – Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit

Kjo certifikatë është e nevojshme pasi objekti i kontratës përfshin projektimin dhe/ose integrimin e sistemeve të automatizimit, mbrojtjes, telekomunikacionit dhe SCADA, si dhe administrimin e dokumentacionit teknik dhe të dhënave të infrastrukturës kritike elektroenergjetike. Standardi garanton që operatori ekonomik disponon politika dhe procedura për mbrojtjen e konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë së informacionit gjatë gjithë ciklit të realizimit të kontratës, duke reduktuar rrezikun e humbjes, aksesit të paautorizuar ose komprometimit të të dhënave teknike.

Ky argumentim është në përputhje me objektin e kontratës dhe justifikon proporcionalisht kërkesën për secilën certifikatë, duke lidhur drejtpërdrejt sistemet e menaxhimit me natyrën, kompleksitetin dhe rëndësinë e punimeve në nënstacionet elektrike të detajuara si mëposhte:

Mbron konfidencialitetin e të dhënave dhe informacionin teknik të projektit.

Parandalon aksesin e paautorizuar, humbjen ose ndryshimin e të dhënave elektronike të pajisjeve, mbrojtje, matëse komanduese etj.

Siguron kontroll të aksesit për personelin që përdor softëra, konfigurime ose sisteme monitorimi.

Mbështet sigurinë kibernetike të sistemeve teknologjike, veçanërisht në integrim me SCADA, nga sistemi lokal në atë qendror dhe sistemi i telekomunikacionit në transmetimin e të dhënave.

Përcakton procedurë për backup, rikuperim dhe menaxhim incidentesh, për të garantuar vazhdimësinë e punës.

Siguron përputhshmëri me kërkesat teknike dhe organizative për infrastrukturë kritike dhe sisteme automatizimi.

SSH EN ISO 14001:2015 ose ekuivalente – Sistemi i menaxhimit të mjedisit

Certifikatë SSH EN ISO 14001:2015 ose ekuivalente mbi “Sistemin e menaxhimit të mjedisit”, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim.

Kjo certifikatë është e nevojshme pasi objekti i kontratës përfshin punime të linjes kabllorë 35kV nga N.Stacioni Kinostudio në shtyllën e parë ajrore afër zonës së Linzës në Tiranë, linjë me gjatësi mbi 2 (dy) km, që do të jetë nën rrugë, ku ka kanale me ujë dhe qëllimi kryesor

është për të siguruar që projekti minimizon dëmet ndaj natyrës dhe përmbush detyrimet ligjore të objektit.

2.3.12 Operatorët ekonomik ofertues duhet të plotësojnë skedën teknike të pajisjeve sipas të dhënave të ofertuara.

Argumentim. 2.3.12.

Kjo kërkesë është vendosur në përputhje me parimet e transparencës, proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit të operatorëve ekonomikë, si dhe me dispozitat e Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar, dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, pasi i shërben verifikimit të aftësisë së operatorëve ekonomikë për të ofruar pajisje që përmbushin plotësisht kërkesat teknike të Autoritetit Kontraktor, duke garantuar njëkohësisht mbrojtjen e interesit publik dhe përdorimin efektiv të fondeve publike.

Kërkesa që operatorët ekonomikë ofertues të plotësojnë Skedën Teknike të detajuar në piken 2.3.5 të pajisjeve sipas të dhënave teknike të ofertuara është vendosur për t'i mundësuar Autoritetit Kontraktor verifikimin e plotë të përputhshmërisë së ofertës me specifikimet teknike të objektit të prokurimit, si dhe për të garantuar një proces vlerësimi transparent, objektiv dhe të bazuar në kritere të matshme.

Plotësimi i Skedës Teknike nga vetë operatori ekonomik përbën një deklaram zyrtar të karakteristikave teknike të pajisjeve që ofrohen dhe shërben si bazë për vlerësimin e ofertës teknike. Nëpërmjet saj evidentohen në mënyrë të qartë dhe të unifikuar të gjithë parametrat teknikë të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, karakteristikat funksionale, parametrat elektrikë dhe mekanikë, standardet e zbatueshme, certifikimet, performancën, prodhuesin, modelin, vendin e origjinës dhe çdo informacion tjetër të kërkuar në Dokumentet e Tenderit.

Kjo kërkesë siguron që çdo ofertë të paraqitet në një format të standardizuar, duke mundësuar krahasimin objektiv të ofertave mbi të njëjtat elemente teknike dhe duke shmangur interpretimet subjektive apo paqartësitë që mund të lindin nga paraqitja e dokumentacionit teknik në forma të ndryshme. Njëkohësisht, ajo lehtëson procesin e verifikimit të katalogëve teknikë, broshurave, certifikatave të konformitetit, raporteve të testimeve dhe dokumentacionit tjetër mbështetës të paraqitur nga operatorët ekonomikë.

Për më tepër, Skeda Teknike përbën një dokument referues gjatë fazës së zbatimit të kontratës, pasi karakteristikat teknike të deklaruara nga operatori ekonomik do të shërbejnë si bazë për verifikimin e pajisjeve që do të furnizohen, kontrollin e pranimi, kryerjen e testeve dhe kolaudimin e objektit të kontratës. Në këtë mënyrë, reduktohet rreziku i furnizimit me pajisje që nuk përmbushin kërkesat e Autoritetit Kontraktor dhe garantohet realizimi i kontratës në përputhje me parametrat teknikë të ofertuar.

Argumentimi i specifikimeve teknike:

Në dokumentacionin Teknik për realizimin e këtij projekti janë bashkëlidhur dokumentet me emërtimin "Relacioni Teknik Rikonstruksion i N.Stacioni Kinostudio dhe kalimi në nivel tensioni 110kV" nga Kapitullin 12, fq. 77, deri në kapitullin e fundit 17 fq 241 janë paraqitur specifikimet teknike të detajuara për mallrat pjesë e kësaj procedure sipas skedës teknike dhe

ne dokumentin tjetër bashkëlidhur po kësaj procedure me emërtimin “Skeda Teknike Rikonstruksion i N.Stacioni Kinostudio dhe kalimi ne nivel tensioni 110kV” janë paraqitur specifikimet teknike për mallrat e kërkuar si dhe kollona për tu plotësuar nga Operatoret Ekonomik me mallrat e ofertuara.

Specifikimet teknike janë hartuar për të orientuar sa më mirë në mënyrë të qartë dhe të detajuar OE lidhur me punimet që do të kryhen, pajisjet që do të furnizohen, montimet, instalimet, kolaudimet dhe venien në punë të plotë të N.Stacioni Kinostudi me një nivel me të lartë tensioni, 110kV.

Këto specifikime janë të domosdoshme për të garantuar që investimi të realizohet në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare për këto punime dhe të sigurojë një nënstacion elektrik të shpërndarjes, të sigurt, me parametra teknike standarte dhe me një jetëgjatësi të lartë.

Specifikimet teknike janë hartuar duke respektuar kërkesat e legjislacionit në fuqi shqiptar SSH, standardet IEC, EN, ISO, ekuivalentet e tyre, si dhe kërkesat teknike të vecnata të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) për N.Stacionin duke qenë në punë, për të mos ndikuar në ndërprerjen e energjisë për konsumatorët, por edhe me kërkesat e Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST), duke qenë pika e lidhjes me Sistemin Elektroenergjetik Shqiptar, si dhe garantimin e përputhshmërisë së plotë me këtë sistem.

Domosdoshmëria e specifikimeve teknike për këtë procedure argumentohet si më poshtë:

Duhet të garantojnë se pari siguri e Sistemit Elektroenergjetik Shqiptar.

Pajisjet e nënstacionit 110 kV janë elementë kritikë dhe të rëndësishëm të rrjetit elektrik. Përcaktimi i parametrave teknikë të tyre siguron funksionim të qëndrueshëm, selektivitet të mbrojtjeve duke lokalizuar dhe parandaluar përhapjen e një defekti në kaskadë, koordinim korrekt të izolimit dhe minimizimin e rrezikut të avarive.

Sigurojnë përputhshmërinë ndërmjet të gjitha pajisjeve.

Specifikimet teknike garantojnë që transformatori i fuqisë, çelësat e fuqisë, ndarësit, transformatorët e rrymës dhe tensionit, shkarkuesit nga mbitemensionet, sistemet SCADA, reletë mbrojtëse, sistemet e matjes, telekomunikacionit sisteme DGA, BMT pajisjet TM/TU dhe pajisjet ndihmëse të jenë plotësisht në koordinim me njëra – tjetrën dhe të funksionojnë si një sistem unik.

Garantojnë cilësinë dhe jetëgjatësinë e pajisjeve.

Kërkesat për pajisjet, punimet, instalimet kolaudimet, venien në punë të plotë të N.Stacionit, testimet FAT, SAT etj. të sigurojnë që pajisjet të kenë jetë të gjatë shërbimi, besueshmëri të lartë, kosto minimale mirëmbajtjeje dhe me të rëndësishmja të jenë të sigurta për personelin operativ të tij.

Sigurojnë funksionim të pandërprerë.

Përzgjedhja e parametrave të duhur teknikë duhet që të sigurojnë punim të pandërprer të furnizimit me energji elektrike.

Garantojnë sigurinë e personelit dhe pajisjeve.

Specifikimet teknike përcaktojnë kërkesat për sistemin e tokëzimit, mbrojtjen nga mbitensionet dhe shkarkimet atmosferike, koordinimin e izolimit, distancat e sigurisë, mbrojtjen nga harku elektrik, sistemet kundër zjarrit dhe masat e tjera të sigurisë, duke reduktuar rrezikun e aksidenteve dhe dëmtimeve.

Sigurojnë monitorim dhe komandim në kohë reale.

Integrimi i sistemit SCADA, sistemeve të automatizimit dhe telekomunikacionit mundëson monitorimin 24/7 të gjendjes së nënstacionit, komandimin në distancë të pajisjeve, regjistrimin e ngjarjeve dhe analizën e parametrave elektrikë në kohë reale.

Lehtësojnë mirëmbajtjen dhe diagnostikimin.

Pajisjet e pajisura me funksione mbrojtje, kontroll, komandim, diagnostikuese dhe monitorim online si DGA dhe BMT, komunikimi sipas standardeve e protokolleve ndërkombëtare mundësojnë identifikimin në kohë të anomalive, planifikimin e mirëmbajtjes parandaluese dhe uljen e kostove operative.

Garantojnë mundësinë e zgjerimit të ardhshëm.

Specifikimet teknike janë hartuar në mënyrë që nënstacioni të ketë mundësi fuqizimi në të ardhmen pa ndërhyrje të konsiderueshme në infrastrukturën ekzistuese, përveç pajisjeve shtese të nevojshme instalimit dhe venies në punë të tyre.

Garantojnë konkurrencë të drejtë dhe transparencë.

Specifikimet teknike janë hartuar mbi bazën e kërkesave funksionale dhe standardeve ndërkombëtare, janë transparente dhe të realizueshme për këto lloje punimesh dhe objekte, pa favorizuar marka apo prodhues të caktuar, duke lejuar ofertimin e pajisjeve ekuivalente që plotësojnë të njëjtin nivel performante, sigurie dhe cilësie.

Përcaktimi i specifikimeve teknike është në përputhje me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar, sipas të cilave autoriteti kontraktor ka detyrimin të përshkruajë me saktësi karakteristikat teknike të objektit të prokurimit, duke garantuar konkurrencë të ndershme, trajtim të barabartë të operatorëve ekonomikë dhe përdorim efikas të fondeve publike.

Për sa më sipër, specifikimet teknike dhe kriteret e vlersimit për këto procedura, janë të domosdoshme për të garantuar që Nënstacioni Kinostudio të projektohet, rikonstruktohet, fuqizohet dhe vihet në punë në përputhje me standardet më të fundit teknike, duke siguruar furnizim të sigurt dhe të vazhdueshëm me energji elektrike, rritjen e sigurisë së tij me Sistemin Elektroenergjitik Shqiptar gjatë gjithë ciklit të jetës së tij në punë.

Realizimi i këtij projekti do të jete 18 muaj nga data e dorezimit të sheshit të ndërtimit dhe do të jete sipas termiit "çelësa në dorë" për arsyet e mëposhtme:

Përfitimet e realizimit të projektit sipas modelit "Çelësa në Dorë" (Turnkey Project)

Realizimi i projektit sipas modelit "Çelësa në Dorë" (Turnkey Project) paraqet një sërë përfitimesh të rëndësishme për Autoritetin Kontraktor, veçanërisht për projekte komplekse të infrastrukturës elektroenergjetike, si nënstationet elektrike, transformatorët e fuqisë, sistemet SCADA, telekomunikacion, sistemet e mbrojtjes dhe kontrollit, si dhe instalimet elektrike.

Përfitimet kryesore janë si më poshtë:

Përgjegjësi e vetme kontraktuale

Kontraktori merr përsipër përgjegjësinë e plotë për projektimin, furnizimin, prodhimin, transportin, instalimin, testimin, vënien në punë, trajnimin dhe dorëzimin e objektit të përfunduar. Kjo eliminon konfliktet dhe paqartësitë që mund të lindin ndërmjet kontraktorëve të ndryshëm lidhur me përgjegjësitë teknike.

Reduktimi i rreziqeve të projektit

Rreziqet që lidhen me projektimin, koordinimin, furnizimin, ndërtimin dhe integrimin e sistemeve transferohen tek Kontraktori. Si rezultat, Autoriteti Kontraktor minimizon rreziqet që lidhen me vonesat, papajtueshmërinë ndërmjet pajisjeve dhe gabimet në projektim apo zbatim.

Garanci për përputhshmërinë dhe integrimin e sistemit

Të gjitha pajisjet projektohen, prodhohen, furnizohen dhe integrohen si një sistem unik dhe funksional. Sigurohet përputhshmëria ndërmjet pajisjeve primare, sistemeve sekondare, SCADA, telekomunikacionit, mbrojtjes, kontrollit dhe sistemeve ndihmëse.

Shkurtimi i afatit të realizimit

Projektimi, furnizimi, prodhimi dhe instalimi mund të zhvillohen paralelisht, duke reduktuar ndjeshëm kohën totale të zbatimit krahasuar me kontratat e ndara për secilën fazë.

Rritja e cilësisë së zbatimit

I gjithë projekti menaxhohet sipas një sistemi unik të kontrollit të cilësisë. Testimet në fabrikë (FAT), testimet në vend (SAT), vënia në punë dhe testet e performancës realizohen në mënyrë të koordinuar nga i njëjti Kontraktor.

Menaxhim më i thjeshtë i kontratës

Administrimi i projektit bëhet më efikas pasi menaxhohet vetëm një kontratë. Komunikimi, raportimi, kontrolli i dokumentacionit dhe procedurat e pagesës thjeshtohen ndjeshëm.

Optimizimi i zgjidhjeve teknike

Kontraktori ka mundësinë të optimizojë projektimin dhe përzgjedhjen e pajisjeve duke garantuar njëkohësisht përmbushjen e specifikimeve teknike dhe standardeve ndërkombëtare IEC, EN dhe ISO.

Garanci për realizimin e projektit

Kontraktori garanton funksionimin korrekt të të gjithë instalimit sipas kërkesave teknike të kontratës. Përgjegjësia për performancën nuk mund të transferohet tek furnitorët ose nënkontraktorët.

Dokumentacion i plotë dhe trajnim i personelit

Në përfundim të projektit dorëzohen dokumentacioni "As Built", manualët e operimit dhe mirëmbajtjes, licencat e nevojshme të softuerëve (kur aplikohen), listat e pjesëve rezervë dhe zhvillohet trajnimi i personelit të Autoritetit Kontraktor.

Përgjegjësi e unifikuar gjatë periudhës së garancisë

Gjatë periudhës së garancisë, Kontraktori mban përgjegjësi të plotë për eliminimin e çdo defekti, pavarësisht nëse ai lidhet me projektimin, pajisjet, instalimin, programimin ose procesin e vënies në punë.

Objekt plotësisht funksional në dorëzim

Pas përfundimit të kontratës, Autoriteti Kontraktor merr në dorëzim një objekt plotësisht funksional dhe të gatshëm për operim, pa pasur nevojë për ndërhyrje shtesë në projektim, furnizim apo integrim.

Për këto arsye, modeli "Çelësa në Dorë" konsiderohet zgjidhja më e përshtatshme për projekte komplekse të infrastrukturës elektroenergjetike, ku realizimi me sukses varet nga integrimi i plotë i pajisjeve, sistemeve dhe disiplinave të ndryshme teknike, nën një përgjegjësi të vetme teknike dhe kontraktuale.

Afati i realizimit të kontratës prej 18 (tetembedhjetë) muaj, nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit, është përcaktuar duke marrë në konsideratë natyrën, kompleksitetin dhe shtrirjen e punimeve që përfshin objekti i kontratës. Projekti përfshin hartimin e projektit të zbatimit, furnizimin e pajisjeve, prodhimin dhe testimin e tyre në fabrikë, transportin, kryerjen e punimeve civile dhe elektromekanike, instalimin, integrimin me sistemet ekzistuese, testimet në terren, vënien në punë, provat funksionale dhe dorëzimin përfundimtar të objektit.

Kontrata do të realizohet sipas termit "çelësa në dorë" (Turnkey), pasi qëllimi i autoritetit kontraktor është të sigurojë një zgjidhje të plotë dhe funksionale, ku operatori ekonomik mban përgjegjësi të plotë për projektimin, furnizimin, ndërtimin, instalimin, testimin, vënien në punë dhe dorëzimin e objektit në gjendje plotësisht operative. Ky model kontraktimi garanton koordinimin e të gjitha fazave të projektit nga një subjekt i vetëm, shmang problematikat që mund të lindin nga ndarja e përgjegjësi ndërmjet operatorëve të ndryshëm dhe siguron përputhshmërinë e plotë ndërmjet projektimit dhe zbatimit.

Përcaktimi i afatit prej 18 muaj është proporcional me kohën e nevojshme për:

hartimin dhe miratimin e dokumentacionit të projektimit;

prodhimin dhe furnizimin e pajisjeve, të cilat kanë afate të konsiderueshme prodhimi;

kryerjen e testimeve në fabrikë (Factory Acceptance Tests – FAT) dhe testimeve në vendin e instalimit (Site Acceptance Tests – SAT), sipas specifikimeve teknike;

realizimin e punimeve civile, elektrike dhe elektromekanike;

integrimin e pajisjeve me sistemet ekzistuese të nënstacionit, përfshirë sistemet e mbrojtjes, automatizimit dhe SCADA, kur është e aplikueshme;

kryerjen e provave funksionale, vënien në punë dhe dorëzimin e objektit në funksionim normal.

Për rrjedhojë, afati prej 18 (tetëmbëdhjetë) muaj dhe realizimi i kontratës sipas termit "çelësa në dorë" janë në përputhje me natyrën dhe kompleksitetin e projektit, garantojnë koordinimin efektiv të të gjitha fazave të zbatimit, reduktojnë rreziqet teknike dhe organizative dhe sigurojnë dorëzimin e një objekti plotësisht funksional, në përputhje me kërkesat teknike dhe standardet në fuqi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Në të gjitha rastet kur AK në specifikimet teknike i është referuar vetëm standarteve europiane, Autoritetit Kontraktor do të pranojë edhe paraqitjen e standarteve SSH/DIN/UNI/EN/ISO.

Shënim:

Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit kontraktor. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese Autoriteti Kontraktor ka te drejte te kryeje verifikimet e nevojshme mbi vertetesine e informacionit te deklaruar nga operatori ekonomik si me siper ose te kerkoje operatorit sqarime dhe dokumente mbeshetese per keto sqarime ne perputhje me nenin 24 pika 1 te VKM nr.28 date 19.05.2021 per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik.

Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të plotësojnë formularin e ofertës, sipas kërkesave të përcaktuara në shtojcën 1, pjesë e këtyre dokumenteve të tenderit.

Gjithashtu Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të plotësojnë edhe preventivin e punimeve i cili është vënë në dispozicion nga autoriteti kontraktor, pjesë e këtyre dokumenteve të tenderit.

Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, sjellim ne vemendje se:

- Autoriteti Kontraktor do të beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimet e bera në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht s’kualifikimi.

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

PJESA I: A. INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik
(nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:			
Informacione për nënkontraktorin			
Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar
Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik			
Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: SHKAQET E PËRJASHTIMIT

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: _____ _____ etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së. Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, Deklaroj Se:

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër⁵.

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me:

çmimet;
metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t’u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

C: DEKLARATA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

⁵ Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:

- Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

“Per permbushjen e specifikimeve teknike dhe grafikut e realizimit të objektit të kontratës”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me preventivin e punimeve dhe grafikun e zbatimit të punimeve të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	Po [] Jo []

B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”

Deklarata	Përgjigje
